



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:219562  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05745191

**Ac.nr.10808/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.J., nga Prishtina, të cilën e përfaqëson me autorizim F.P., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Telekom i Kosovës sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H.I., me objekt të kontestit kompensim i diferencës në pagë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.534/2015, të datës 23.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditëses F.J., nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.534/2015, i datës 23.03.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.534/2015, të datës 23.03.2021, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses F.J. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Telekom i Kosovës sh.a në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të diferencës në pagë në mes të gradës 9 në 10 për periudhën 01.01.2015 deri me 31.12.2020, t’ia paguaj shumën neto prej 6,647.20 euro, në emër të kontributit pensional të paguaj shumën 777.46 euro, dhe në emër të tatimit në pagë të paguaj shumën prej 738.58 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë 06.03.2015, dhe në të ardhmen nga data 01.01.2021 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore t’ia paguan paditëses pagën me gradë 10, ti dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 763.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita

e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përmbartimit forcërisht". Në pikën II, ka caktuar që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta ndryshoj aktgjykimin e goditur dhe të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar ose të prish aktgjykimin e goditur dhe të kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 06.03.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës për shkak të kompensimit të diferencës në pagë në mes të gradës 10 dhe 9. Në padi ka parashtruar së paditësja ka lidhur me të paditurën kontratë pune, dhe me aktvendimin për lartësinë e pagës e cila është protokolluar me nr.01-1245/13, datë 25.03.2013, është paraparë së paditësja për punët e kryera të kompensohet sipas pagës bazë në lartësi të gradës 10, kurse me kontratën e punës nr.01-6182-661/2014, datë 31.12.2014, paditëses i është ndërruar pozita dhe i është caktuar paga bazë në lartësi të gradës 9. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare përmes parashtrësës me shkrim ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke kërkuar që detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj diferencën e ndryshimit në pagë në mes të gradës 9 dhe 10 për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2020, në shumën neto prej 6,647.00 euro, diferencën e kontributit pensional në Trust, diferencën e tatimit në pagë, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.534/2015, të datës 23.03.2021, me të cilën e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara në këtë çështje ka gjetur se paditësja në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratën e punësimit me nr. 01-6182-661/2014 e datës 31.12.2014, e cila kontratë ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 e lidhur në kohë ta pacaktuar. Në kryerjen e detyrave të punës Zyrtare për Marketing, ku sipas nenit 5 të kontratës është përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në

lartësi të gradës 9. Ngase sipas aktvendimit mbi risistemimin e punëtorit nr.01-1245/2013 datë 25.03.2013, i cili vendim ka qenë pjesë përbërëse e kontratës së punës nr.01-2880-1565 datë 20.10.2011, baza e të ardhurave personale mujore ka qenë në lartësi të gradës 10. Gjykata ka vlerësuar se kontrata është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës. Meqenëse lidhja e kontratës së punës ishte në pajtim me dispozitat ligjore, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses për periudhën kontestuese për kompensimin e diferencës së pagave të papaguara është e pabazuar edhe pse me propozimin e paditëses është bërë llogaritja e të ardhurave personale me anë të ekspertizës financiare. E drejta e kompensimit të ardhurave personale paditëses do t'i takonte vetëm në situatën kur ndryshimi i kushteve të kontratës së punës do të ishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjykata ka vlerësuar se kushtet e kontratës së punës të lidhur mes paditëses dhe të paditurës, duke përfshirë edhe lartësinë e pagës përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditëses janë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës. Sipas vlerësimit të gjykatës marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktore ku palët duhet të respektojnë kushtet për lidhjen e kontratës. Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar gjykata vendosi lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë në bazë të nenit 11 të Ligjit të Punës. Lidhur me shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë pretendimet tjera ankimore të parashtruara nga pala paditëse me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Nuk qëndron as pretendimi ankimor se aktgjykimi përmban të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, është kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit, pasi që aktgjykimi i atakuar është mjaftë i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe arsyetimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo-juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritorë. Ndërsa pretendimi se nga arsyetimi i aktgjykimit ku thuhet se “paditëses i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 9, kurse edhe sipas kontratës tjetër përcaktohet lartësia e gradës 9”, dhe se ku fakt e bën aktgjykimin të paqëndrueshëm, jo të drejtë dhe të paligjshëm, Gjykata ankimore e vlerëson si pretendim të pabazuar për faktin se gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse për mënyrën e vendosjes ndërsa konstatimi se paditëses i caktohet paga bazë në

gradën 9, kurse edhe sipas kontratës tjetër përcaktohet lartësia e gradës 9, rezulton së ky konstatim nga gjykata e shkallës së parë është dhënë pasi që paditësja me të paditurën i ka lidhur dy kontrata me lartësinë e gradës 9, njëra me numër 01-6182-661/14, datë 31.12.2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, dhe tjetra me numër 01-4145/208/20215, datë 02.09.2015, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.09.2015.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse e që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për faktin se kësaj gjykate i ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, pasi që e ka vërtetuar faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në kohë ta pacaktuar me të paditurës sipas kontratës me nr.01-6182-661/16, të datës 31.12.2014, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, në pozitën Zyrtare Marketingu, me nivelin e gradës 9. Gjithashtu drejtë e ka konstatuar gjendjen faktike edhe sa i përket përmbajtjes së kontratës së punës të cilën e ka vlerësuar se është në përputhje me dispozitën e nenit 11 të Ligjit të Punës dhe të cilën paditësja vullnetarisht ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurën duke paraparë kushtet, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë kontraktuese.

Me rastin e lidhjes së kontratës së punës, paditësja në cilësinë e punëmarrëses dhe e paditura në cilësinë e punëdhënëses kanë lidhur kontratë për kohë të pa caktuar ku paditëses, në këtë rast punëmarrëses, i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 9 dhe çfarëdo ngritje të gradës do të mund të bëhej vetëm më pëlqimin dhe pajtimin e dy palëve kontraktuese qoftë përmes aneksit apo ndryshimit të kontratës së punës, ndërsa nuk hyn në kompetencën e gjykatave që të bëjë rregullimin e raporteve në mes punëdhënësve dhe punëmarrësve lidhur me nivelin e pagesës apo gradave. Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale me referencë në nenin 11 të Ligjit të Punës, e cila dispozitë e rregullon përmbajtjen e kontratës ku njëri nga elementet të cilat duhet t'i përmbajë kontrata e punës është caktimi i lartësisë së pagës bazë, dhe në rastin konkret palët janë pajtuar që të nënshkruajnë kontratë të punës sipas së cilës paga bazë është caktuar në lartësi të gradës 9.

Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që i njëjti vendim është në përputhje të plotë me provat materiale të administruara nga shkalla e parë. Është rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raportin juridik gjegjësisht marrëdhënien juridike. Në rastin konkret paditësja e ka nënshkruar kontratën në fjalë dhe sipas nenit 24 të kësaj kontrate e njëjta ka qenë e njoftuar me përmbajtjen e kontratës. Paditësja ka dështuar të provoj faktin së këtë kontratë e ka lidhur me detyrim, mashtrim apo lajthim. Për me tepër, paditësja nuk e ka provuar faktin se me rastin e lidhjes – nënshkrimit të kontratës Nr.01-6182-661/14, datë 31.12.2014, të ketë paraqitur kundërshtim në lidhje gradën e cila i është caktuar me këtë kontratë, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në qoftë se paditësja ka qenë e pakënaqur me përmbajtjen e kontratës, përkatësisht me gradën 9 e njëjta ka pasur mundësi dhe është dashur që ta bëjë një kundërshtim të tillë para lidhjes së kontratës. Në rastin konkret ankesa e paditëses drejtuar Komisionit të Ankesave në PTK, është paraqitur me datë 27.01.2015, ndërsa kontrata e punës për kohë të

pacaktuar Nr.01-6182-661/14, mban datën 31.12.2014, dhe ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, ndërsa paditësja këtë kontratë e ka nënshkruar me datë 14.01.2015, që do të thotë që ankesa është paraqitur pas nënshkrimit të kontratës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, përkatësisht dispozitën e nenit 450, ndërsa rezulton se pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10808/2021, më datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Hysni Bardheci